



## Raporti mujor mbi ndjekjen e Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore - korrik 2017 -

### I Gjyqësori

#### 1. Pavarësia

##### **Pushim mjekësor dhe tërheqja e gjykatësve të cilët vendosën për propozim-masat për arrest të PSP-së**

Gjykata Themelore Shkup 1 informoi se nga këshilli penal i tre gjykatësve (Biljana Kocevaska, Darko Todorovski dhe Diana Gruevska Ilievaska) që është formuar për të vendosur në lidhje me kërkesën e dorëzuar për përcaktim të masës arrest nga PSP-ja për lëndën “Titanik” kundër ish-shefit të Drejtorisë së Pestë të MPB, Goran Grujovski dhe katër personave të tjerë, gjykatësja Kocevaska për shkak të problemeve shëndetësore të cilat janë përcaktuar sipas gjykatës nga mjeku dezhurn më 01.07.2017 (e shtunë) është penguar të marrë pjesë në vendimmarrje. Në vend të saj është caktuar gjykatësja Xheneta Bektoviq.<sup>1</sup> Mbetet e panjohur se si të akuzuarit dhe mbrojtja e ka marrë vesh përbërjen e këshillit penal që në të njëjtën ditë në orën 17:20 të kërkojnë tërheqje të gjykatësit Todorovski në sekretarinë e gjykatës. Nga gjykata nuk dolën me shpjegim konkret për këtë edhe pse lajmi shkaktoi reagime të stuhishme në publik dhe në media.

##### **Kryetarë të rinj të Gjykatës Administrative dhe të gjykatave themelore në Gjevgjeli, Sveti Nikollë dhe Krushevë**

Këshilli Gjyqësor informoi se në seancën 259 të mbajtur më 03.07.2017 ka konstatuar zgjedhjen e kryetarëve të rinj të gjykatave themelore në Gjevgjeli, Sveti Nikollë, Krushevë dhe të Gjykatës Administrative. Për të gjitha pozitat është shpallur edhe konkurs.<sup>2</sup> Nuk është zgjedhur vetëm kryetari i ri i Gjykatës Themelore Kumanovë, sepse kandidatët nuk e kanë fituar shumicën e nevojshme të votave të Këshillit. Në seancën 260 Këshilli Gjyqësor mori vendim për publikim të shpalljes për zgjedhje të kryetarëve të këtyre gjykatave në vijim: Gjykata e Apelit Shtip, Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup, Gjykata Themelore Kumanovë, Gjykata Themelore Tetovë, Gjykata Themelore Dibër dhe Gjykata Themelore Resnjë.<sup>3</sup>

<sup>1</sup><http://bit.ly/2hITGPx>

<sup>2</sup><http://bit.ly/2vI60Iz>

<sup>3</sup><http://bit.ly/2uF8G2g>



## **PTHP NKOK e dorëzoi lëndën “Sopot” në kompetencë të PSP-së**

PSP-ja për Ndjekjen e Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHP NKOK) kërkoi nga Këshilli i Prokurorëve Publikë që të deklarohet se a është kërkesa për dorëzim të lëndës penale “Sopot” veprim i ligjshëm i prokurorit publik i cili udhëheq me PSP-në, duke marrë parasysh se kjo ngjarje penale-juridike ka ndodhur para vitit 2008, ose më saktë në 2003, lënda që është kërkuar nuk lidhet dhe nuk del me përmbajtjen e ndjekjes së paautorizuar të komunikimeve.<sup>4</sup>

Këshilli i prokurorëve publikë ka informuar me shkrim PTHP NKOK-në pa thënë në mënyrë decide se a e ka dorëzuar lëndën, duke thënë se PTHP NKOK duhet të vendosë në mënyrë të pavarur a ta dorëzojë lëndën e dhënë te PSP-ja. Si rrjedhim, PTHP NKOK vendosi lëndën “Sopot” që është në fazën e procedurës gjyqësore të shkallës së parë para Gjykatës Themelore Shkup 1 – Shkup, me shkresat e saj, megjithatë t’i dorëzohet PSP-së që ajo të deklarohet se a do ta marrë në kompetencat e saj.

## **Analiza e zbatimit të standardeve ndërkombëtare për gjykim të ndershëm dhe të drejtë**

Në suazat e “Rrjetës 23” është prezantuar analiza<sup>5</sup> e përgatitur nga “Koalicioni të Gjithë për Gjykim të Drejtë” e cila është zbatuar me mbikëqyrje të 80 procedurave gjyqësore, prej të cilave 60 ishin penale dhe 20 qytetare në dy gjykatat themelore në Shkup. Kjo analizë jep kontributin e vet në shqyrtimin e gjendjeve në gjyqësor nëpërmjet prizmit të pavarësisë së tij, si një pamje reale “nga terreni” të dhënë nëpërmjet përvojave të mbikëqyrësve, gjatë veprimit të gjykatave në procedurat përkatëse. Lëndët janë analizuar nga aspekti i të drejtës së gjykatës së pavarur dhe së paanshme, gjykimit në afat, publiku, supozimi i pafajësisë, barazia e armëve, respektimi i të drejtave minimale të mbrojtjes dhe të drejtës së ankesës dhe e njëjta e përfshin edhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>6</sup> Me përjashtime të vogla, analiza dëshmon një zbatim relativisht të drejtë te standardeve të gjykimit të drejtë dhe të ndershëm, duke e theksuar mundësinë për përmirësim.

## **Analiza e zbatimit të Ligjit për Përcaktim të Llojit dhe Madhësisë së Dënimit**

Analiza e zbatuar nga Këshilli për Parandalim kundër Delikuencës së të Miturve (KPDM), e prezantuar në korrik, kishte për qëllim të përcaktojë ndikimin e Ligjit për Përcaktim të Llojit dhe Përcaktim të Madhësisë së Dënimit (LPLLPM) mbi politikën dënuese.<sup>7</sup> Nëpërmjet analizës krahasuese të 150 aktvendimeve të gjykatave në Tetovë, Veles, Koçan dhe Kavadarci, është përcaktuar se një ligj me përmbajtje të ngjashme nuk as ekziston në shtetet evropiane, as në shtete me të drejtë anglosaksone, ku dispozitat janë me natyrë konsultuese ose përbëjnë vetëm udhëzime, përkatësisht pikë nisjeje për përcaktim të sanksionit. Sipas analizës, implikimet e LPLLPM-së mbështeten kryesisht në: pranimin e shpeshtë të fajit në seancën kryesore; zbatimin e shpeshtë të procedurave për lëshim të urdhëresës dënuese; sanksionimin më të lehtë për vepra më të rënda penale; sanksionimin më të rreptë për vepra

<sup>4</sup><http://jorm.gov.mk/?p=4139>.

<sup>5</sup>[http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Megunarodni-standardi\\_fer-i-pravicno-sudenje.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Megunarodni-standardi_fer-i-pravicno-sudenje.pdf)

<sup>6</sup><http://www.merc.org.mk/aktivnost/25/analiza-na-implementacijata-na-megjunarodnite-standardi-za-fer-i-pravicno-sudenje-vo-makedonija>

<sup>7</sup>[http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Analiza\\_Primena-na-ZOVOVK\\_SPPMD-Juni-2017.pdf](http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/studies/Analiza_Primena-na-ZOVOVK_SPPMD-Juni-2017.pdf)



më të lehta penale; mungesën e njëtrajtshmërisë në praktikë. Në bazë të kësaj, hulumtuesit rekomandojnë intervenime përkatëse ligjore.<sup>8</sup>

## 2. Paanshmëria

### **Këshillat penalë të Gjykatës Themelore Shkup 1 vendosin mbi propozimet e PSP-së për masat për siguri të pranisë dhe masa për kujdes**

PSP-ja ka dorëzuar propozime për shqiptim të masave për kujdes për 22 persona, prej të cilave 15 janë pranuar, kurse shtatë janë refuzuar. Masa arresti janë propozuar për katër persona, ndërsa të katërta janë refuzuar, kurse gjykata me obligim zyrtar u përcaktoi atyre personave masa për kujdes. Këto propozime ishin për personat të cilët përfshihen në lëndët “Tarifa”, “Thesari”, “Titanik 2”, “Toplik”, “Tenderë”, “TNT” dhe “Trajektorja”.<sup>9</sup>

Për propozimet e propozuara për përcaktim të masave për siguri, pranim dhe masave për kujdes në lidhje me lëndët “Target” dhe “Kështjella”, me të cilat është kërkuar arrest për ish-shefin e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Sasho Mijallkov dhe për ish-shefin e Drejtorisë së Pestë të MPB-së, Goran Grujovski, këshilli penal ato i refuzoi si të pa baza dhe me obligim zyrtar përcaktoi një apo më tepër masa për kujdes (marrje e përkohshme e dokumenteve për udhëtim dhe ndalim i lëshimit të dokumentit të ri, dhe marrje e dokumenteve zyrtare të udhëtimit dhe obligimin për paraqitje të obliguar në gjykatë një herë në javë).<sup>10</sup>

Në lidhje me lëndën “Titanik” këshilli penal i Gjykatës Themelore Shkup 1 i hodhi poshtë kërkesat e PSP-së për përcaktim të masës arrest për ish-kryeministrin, Nikolla Gruevski, ish-ministren e punëve të brendshme, Gordana Jankulovska, ish-shefin e kabinetit të ish-kryeministrit, Martin Protugjer, ish-sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kirill Bozhinovski dhe ish-ministrin e transportit, Mile Janakievski, dhe në lidhje me të gjithë këta persona me obligim zyrtar shqiptoi masë për kujdes.<sup>11</sup>

### **U ndërpre arresti për gazetarin Zoran Bozhinovski**

Duke vepruar sipas propozimit të prokurorit publik për ndërprerje të masës paraburgim për të akuzuarin, Zoran Bozhinovski, i akuzuari në lëndën KOK nr. 79/16, gjykatësi vendimmarrës në seancën kryesore të mbajtur më 14.07.2017 mori vendim me të cilin propozimi i prokurorit miratohet dhe masa arrest ndërpritet, dhe në përputhje me lëndën janë përcaktuar masat parandaluese, prania e të akuzuarit gjatë procedurës.<sup>12</sup>

<sup>8</sup><http://www.merc.org.mk/aktivnost/24/analiza-na-primenata-na-zakonot-za-odreduvanje-na-vidot-i-visitata-na-kaznata>

<sup>9</sup><http://bit.ly/2viYRe0>

<sup>10</sup><http://bit.ly/2vi8BF2>

<sup>11</sup><http://bit.ly/2hIVx6X>

<sup>12</sup><http://bit.ly/2uodCt6>



## **U miratua ankesa e PSP-së për arrest të Grujovskit, Boshkovskit dhe Jakimovskit**

Gjykata e Apelit Shkup pas seancave më 17.07.2017 ka marrë vendime për lëndët “Target” dhe “Kështjella” të cilat lidhen me përgjimin e jashtëligjshëm dhe për shkatërrimin e pajisjeve në Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim. Me këto vendime Gjykata e Apelit për tre të akuzuarit, Goran Grujovski, Toni Jakimovski dhe Nikolla Boshkovski e pranuan ankesën e PSP-së duke i ndryshuar vendimet e shkallës së parë dhe ankesat e PSP-së, kurse për të akuzuarit ka përcaktuar masë arrest, për të siguruar praninë e tyre në procedurën penale, kurse për akuzat e tjera u përcaktuan vendimet e shkallës së parë, kështu që ankesat e të akuzuarve, si dhe të PSP-së janë refuzuar si të pabazuara.<sup>13</sup>

## **Gjykata e Lartë i hodhi poshtë ankesat e mbrojtësve të Grujovskit dhe Boshkovskit, të akuzuarit janë në arrati**

Më 26.07.2017, këshilli prej pesë anëtarësh i Gjykatës Lartë së Republikës së Maqedonisë mori vendime me të cilat janë refuzuar ankesat e mbrojtësve të Goran Grujovskit dhe Nikolla Boshkovskit dhe i përcaktoi vendimet e Gjykatës së Apelit Shkup për përcaktim të masës së arrestit në afat prej 30 ditësh.<sup>14</sup>

Me pranimin e veprimit suspendues të ankesës, u la hapësirë për arratisje të të akuzuarve, që shkaktoi mospajtim serioz në publikun ekspert prandaj kërkohej edhe përgjegjësi prej gjykatësve për këtë veprim.

Disa media transmetuan se për shkarkimin eventual dhe përgjegjësinë disiplinore të gjykatësve që kanë vendosur për arrestin e Goran Grujovskit dhe Nikolla Boshkovskit, do të përcaktojë Këshilli për përcaktim të Fakteve, prej nga me vetiniciativë e kanë kërkuar lëndën pasi në media kanë dëgjuar për parregullsitë e mundshme për arrestin, prandaj më pas e gjithë lënda “Target-Kështjella” u është dërguar nga Gjykata Themelore Shkup 1.<sup>15</sup>

## **U refuzua ankesa e PSP-së për arrest të ish-ministres së kulturës Kaçeska-Milevska**

Gjykata e Apelit Shkup pas seancave publike të mbajtura më 24.7.2017 mori vendime në të cilat i hodhi poshtë si të pabazuara kërkesat e të akuzuarve, si dhe ankesën e PSP-së për përcaktim të masës arrest për të akuzuarën Elizabeta Kaçeska-Milevska, ish-ministria për kulturë, i përcaktoi vendimet e shkallës së parë me të cilat janë përcaktuar masat e kujdesit: obligim i të akuzuarës që të paraqitet në gjykatë, marrje e përkohshme e dokumentit të udhëtimit dhe ndalim për lëshim të dokumentit të ri të udhëtimit. Njëkohësisht, Gjykata e Apelit Shkup i përcaktoi vendimet e shkallës së parë me të cilat janë përcaktuar të njëjtat masa të kujdesit për të akuzuarit L.L.C. dhe J.U.<sup>16</sup>

## **Gjykata e Apelit diskutoi mbi ankesën e Peshevskit për Vendimin e Gjykatës Penale me të cili i merret pasaporta<sup>17</sup>**

<sup>13</sup><http://stara.kajgana.com/pritvor-za-goran-grujovski-toni-jakimovski-i-nikola-boshkovski>

<sup>14</sup><http://bit.ly/2vN7AFB>

<sup>15</sup><http://24vesti.com.mk/kje-ima-li-odgovornost-za-sudiite-koi-dozvolija-begstvo-na-grujevski-i-boshkovski>

<sup>16</sup><http://bit.ly/2uF92WE>

<sup>17</sup><http://makfax.com.mk/daily-news/нема-притвор-за-латас-екс-вицепремиер/>



Ish-zëvendëskryeministri i obliguar për çështjet ekonomike, Vladimir Peshevski, ishte i pranishëm në Gjykatën e Apelit ku në seancë publike u diskutua për ankesën e tij për vendimin e Gjykatës Penale që t'i merret pasaporta.

Për ankesën e tij vendosi Këshilli Penal me përbërja: Liljana Ivanovska Shopova si gjykatëse informuese, Jani Niça dhe Afrim Fidani. Ata vendosën ta përcaktojnë vendimin e Gjykatës Penale për marrjen e dokumentit të udhëtimit si masë kujdesi.

Më parë, PSP-ja ka kërkuar arrest për Peshevskin, por Gjykata Penale vendosi vetëm t'ia marrë pasaportën. Prokuroria dorëzoi ankesë te Apeli për përcaktim të masës paraburgim për Peshevskin.

### 3. Profesionalizmi dhe ekspertiza

#### Mbledhje koordinuese në lidhje me Strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit

Në mbledhjen koordinuese të mbajtur në hapësirat e Ministrisë së Drejtësisë, ministri, Bilen Saliji, zëvendësi i tij Oliver Ristovski, si dhe kryetari i grupit të punës për përgatitjen Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor prof. dr. Ana Pavlovska-Daneva, theksuan nevojën e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të të gjithë faktorëve në gjyqësor në procesin e përgatitjes së Strategjisë mbi të cilën punon grupi i punës i formuar në suazat e Ministrisë së Drejtësisë dhe ata që janë thirrur të japin kontribut të sinqertë dhe konstruktiv në këtë reformë, në mënyrë të tillë që shënimet, sugjerimet, hulumtimet, mendimet dhe qëndrimet e veta t'ia dorëzojnë grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë.<sup>18</sup>

#### Takimi i parë i Këshillit për Reformë në Gjyqësor

Ministri i drejtësisë, Bilen Saliji e caktoi mbledhjen e parë të Këshillit për Reforma në Gjyqësor, ku ministri e theksoi rolin e Këshillit për Reforma si trup këshillëdhënës, detyra e parë e të cilit është diskutimi mbi vendimet më të rëndësishme për çështjet juridike të Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor në procesin e versionit të punës deri në miratimin e saj përfundimtar, si dhe për zgjidhjet ligjore të cilat dalin prej saj. Ministri e theksoi, gjithashtu, mundësinë Këshilli të iniciojë vetë çështje, ndryshime ligjore dhe t'i përcaktojë praktikata më të mira për tejkalimin e të gjitha problemeve dhe dilemave të hapura në sektorin e gjyqësorit, si edhe të ketë detyrë kryesore ndjekjen e aktiviteteve të cilat do të dalin për realizimin e Strategjisë dhe Planit të saj aksionar për pesë vitet e ardhshme.<sup>19</sup>

Njëkohësisht zoti Pribe realizoi takim me gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese, ku u fol për gjendjen aktuale në gjyqësorin kushtetues dhe për propozim-masat për përparimin e punës të Gjykatës Kushtetuese, si mbrojtëse e aktit më të lartë juridik në shtet, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.<sup>20</sup>

#### Takimi midis ministrit të drejtësisë dhe kryetarit të DOSHGJ-së

<sup>18</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1375](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1375)

<sup>19</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1376](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1376)

<sup>20</sup><http://ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf>



Ministri i drejtësisë, zoti Bilen Saliji, realizoi takim me kryetarin e DOSHGJ-së, z. Pece Grujovski, i cili e informoi ministrin për problemet me të cilat ballafaqohet kjo sindikatë. Ministri i drejtësisë e bindi z. Grujovski mbi përgatitjen dhe vullnetin e mirë të Qeverisë për përmirësim të kushteve të të punësuarve në këtë sektor shumë të ndjeshëm dhe i njohu përfaqësuesit e sindikatës me zhvillimin e evenimenteve në lidhje me reformat në gjyqësor. Të dyja palët ranë dakord për mbledhje të kohëpaskohshme dhe formim të grupeve të punës në lidhje me përmirësimin e kushteve për të gjithë të punësuarit në organet e gjyqësorit.<sup>21</sup>

### **Këshilli Gjyqësor i RM-së e miratoi Raportin vjetor për punën e vet për vitin 2016**

Raporti vjetor për vitin 2016<sup>22</sup> mbi punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë është shqyrtuar dhe miratuar në seancën e mbajtur më 03.07.2017. Ai i përmban të dhënat mbi punën e Këshillit Gjyqësor në aspektin e gjykatësve dhe gjykatësve porotë të shkarkuar, procedurat mbi përcaktimin e kryerjes joprofesionale të profesionit, vlerësimi mbi punën e gjykatësve, informacionet mbi veprimin sipas ankesave të qytetarëve dhe të dhënat e tjera për punën e gjykatave në RM.

### **PROCEDURA AKTUALE GJYQËSORE**

#### **“Lagjja e trimave” – KOK 127/15**

Seanca e datës 10.07.2017 është shtyrë për më 20.07.2017, me kërkesë të prokurorisë.

Në seancën më 20.07.2017 për rastin “Lagjja e trimave” prokurori publik së pari e prezantoi aktin e prokurorisë. Pastaj, procedura vazhdoi me deklarimin e fjalëve përfunduese nga prokurori publik ku ai iu drejtua çdo të akuzuari, individualisht, me deklarimin e të gjitha dëshmive të cilat prokuroria i posedon kundër të akuzuarve, kurse të cilët akuzohen për vepra penale terroriste të kryera Terrorizëm dhe Organizatë terroriste nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë. Seanca ku do të jepen fjalët përfunduese, do të vazhdojë më 28.07.2017 në orën 9.30.

Në seancën e 28. 07.2017 për rastin “Lagjja e trimave” u vazhdua me dhënien e fjalëve përfunduese nga prokurori publik. Ai në fjalët e tij përfunduese tha se është e pakontestueshme se të akuzuarit kanë kryer këtë vepër në përputhje me dëshmitë të cilat prokuroria publike i nxori kundër të akuzuarve, kërkoi që gjykata t’i shpallë fajtorë për veprat të cilat u ngarkohen dhe t’i dënojë në përputhje me veprën penale sipas Ligjit Penal të Republikës së Maqedonisë, kurse madhësinë e dënimit ia lë gjykatës që ta caktojë.

Mandej i autorizuari i të dëmtuarve deklaroi se u bashkëngjitet tërësisht fjalëve përfundimtare të prokurorit publik dhe kërkon nga gjykata që t’i dënojë të akuzuarit, kurse për kërkesën pronësore-juridike t’i drejtojë në çështje gjyqësore. Gjykata i informoi të pranishmit se me kërkesë të mbrojtjes për

<sup>21</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1372](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1372).

<sup>22</sup>[http://sud.mk/wps/wcm/connect/ssrm/64671434-2331-4bc3-8fba-f58f15f89cdc/IZVESTAJ+ZA+RABOTATA+NA+SSRM+2016.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18\\_L8\\_CC1J41LOB520APQFKICD0CR4-64671434-2331-4bc3-8fba-f58f15f89cdc-IQIFXWY](http://sud.mk/wps/wcm/connect/ssrm/64671434-2331-4bc3-8fba-f58f15f89cdc/IZVESTAJ+ZA+RABOTATA+NA+SSRM+2016.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=ROOTWORKSPACE.Z18_L8_CC1J41LOB520APQFKICD0CR4-64671434-2331-4bc3-8fba-f58f15f89cdc-IQIFXWY)



përgatitje të fjalëve përfunduese dhe për shkak të pushimit vjetor seancat e ardhshme do të mbahen më 30 dhe 31.08.2017 kurse në shtator më 12,14,18,20,22,26 dhe 28.09.2017.

### **Procedurë e ndarë për “Lagjen e trimave” - KOK-95/16**

Në seancën e mbajtur më 19.07.2017, u krye marrje në pyetje e të akuzuarit në cilësi të dëshmitarit të mbrojtjes. Pyetjet në pyetjet e drejtpërdrejta ishin shumë të përgjithshme, kështu që faktikisht i akuzuari tregonte vetë. Pyetjet e kryqëzuara nga PP do të bëhen në seancën e ardhshme të vendosur për më 27.07.2017 në orën 10.00, sepse prokurori kishte shumë pyetje dhe nuk kishte mundësi t'i parashtrijë të gjitha para përfundimit të orarit të punës së gjykatës.

Në seancën e mbajtur më 27.07.2017 u vazhdua me procedurën e dëshmisë dhe marrjen në pyetje të të akuzuarit nga PP dhe gjykata. Seanca e ardhshme është caktuar për më 11.09.2017.

### **“Kështjella 2” -K- 1905/16**

Gjykimi më 03.07.2017 është vendosur në sallë gjyqi ku nuk kishte kushte për mbajtjen e tij. Me kërkesë të mbrojtjes, gjykimi u shtyu menjëherë për më 0.09.2017.

### **“Marriglen” – K 127/16**

Seanca e caktuar për më 11.07.2017 menjëherë pas shtyrjes sepse prokuroria nuk kishte marrë dëshmitë nga gjykatësja, e cila është transferuar në një njësi tjetër në përputhje me rendin e ri të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup do të vazhdojë më 10.10.2017.

### **“ERAZMUS” – KOK 115/16**

Seanca e caktuar për më 03.07.2017, ishte e mbyllur për publikun sepse në pyetje merrej dëshmitari i mbrojtur. Është shtyrë për më 29.08.2017 në orën 10.00.

## **II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT**

### **Mbledhja koordinuese e ministrit të drejtësisë në lidhje me rekomandimet e GREKO-s**

Më 17.07.2017 në Ministrinë e Drejtësisë u mbajt mbledhja koordinuese në lidhje me realizimin e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit - GREKO i Këshillit të Evropës nga rrethi i katër i evalvimit, me temë: “Parandalimi i korrupsionit tek anëtarët e Kuvendit, gjykatësit dhe prokurorët publikë” ku përveç ministrit të drejtësisë, Bilen Saliji, morën pjesë edhe Aneta Arnaudovska, shefja e Delegacionit të RM-së në GREKO, kryetari i Këshillit Gjyqësor, kryetari i Shoqatës së Gjykatësve, kryetari i Shoqatës së Prokurorëve Publikë, kryetari i Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, përfaqësuesi i Kuvendit të RM-së dhe përfaqësues të sektorëve kompetentë nga Ministria e Drejtësisë.

Pjesëmarrësit në këtë mbledhje informuan mbi aktivitetet e ndërmarra për realizimin e mëtejshëm të rekomandimeve për të cilat GREKO, në Raportin e parë për harmonizim për Republikën e Maqedonisë – Rrethi i katërt, ka nxjerrë përfundimin se nuk janë realizuar apo janë realizuar pjesërisht. Duke pasur parasysh faktin se GREKO, me raportin e lartpërmendur e ka përcaktuar 31 janarin 2017 si afatin e fundit



për realizimin e rekomandimeve, janë shkëmbyer edhe informacione mbi gjendjen dhe planet e institucioneve në periudhën e ardhshme në këtë drejtim.<sup>23</sup>

### III TË DREJTAT THEMELORE

#### Sundimi i të drejtës

Gjatë muajit korrik në fushën e sundimit të drejtësisë, janë ndërmarrë disa aktivitete të cilat dalin apo lidhen me planin e Qeverisë së RM-së “3-6-9”. Para së gjithash, partia në pushtet LSDM-ja, në konferencën për shtyp të mbajtur më 25 korrik 2017, theksoi edhe njëherë rëndësinë e reformave në gjyqësor, të përfshira me këtë plan të Qeverisë, kurse të cilat do të “zbatohen në përputhje me praktikata më të mira evropiane, do të sigurojnë gjyqësor të pavarur dhe profesional, të çliuara nga cilat do trysni apo kontrole partiake”. Nga LSDM-ja rikujtojnë se: “Sundimi i të drejtës është interes i lartë dhe nacional (...)”.<sup>24</sup> Në këtë drejtim përpjekja e Qeverisë për sundimin e të drejtës në Maqedoni, ishte realizuar edhe në takimin e zëvendësministrit për drejtësi, Oliver Ristovski me prokuroren dhe këshilltaren juridike në Ambasadën e SHBA-së në Shkup, Rej Vus. Në këtë takim është theksuar se bashkëpunimi midis SHBA-së dhe Maqedonisë duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen, “sidomos në proceset e përforcimit të sundimit të të drejtës, përforcimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.”<sup>25</sup>

Më 17.07.2017 kryetari i Gjykatës së Lartë së Republikës së Maqedonisë, Jovo Vangelovski realizoi takim me grupin e ekspertëve të lartë për çështje sistematike për sundimin e të drejtës e udhëhequr nga Rajnhard Pribe. Në këtë takim është biseduar mbi gjendjen aktuale në gjyqësor dhe propozim-masat për zbatimin e reformave në gjyqësor të përgatitura nga kryetari i Gjykatës së Lartë, me qëllim të realizimit të konceptit për gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm si garanci për demokracinë dhe sundimin e të drejtës, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.<sup>26</sup>

Njëkohësisht zoti Pribe realizoi takim me gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese, ku u fol për gjendjen aktuale në gjyqësorin kushtetues dhe për propozim-masat për përparimin e punës të Gjykatës Kushtetuese, si mbrojtëse e aktit më të lartë juridik në shtet, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.<sup>27</sup>

Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë korrikut kishte aktivitet i cili dilte nga plani qeveritar “3-6-9”, kështu është mbajtur takim pune me anëtarët e grupit të punës (ku marrin pjesë përfaqësues nga MPB-ja, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit, gjykatës në Gjykatën e Lartë, përfaqësues të publikut shkencor dhe ekspert) e formuar në suazat e Projektit të Këshillit të Evropës “Përforcimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut gjatë veprimit të policisë”. Qëllimi i takimit ishte miratimi i modelit për kontroll të jashtëm të policisë, i cili do të mbindërtohet në mekanizmit që ekziston tashmë – Sektori për Kontroll të Jashtëm në MPB. Siç ishte theksuar në këtë takim, ky model duhet t’i përgjigjet “nevojës për vendosje të mekanizmave të pavarur, efikasë dhe në

<sup>23</sup>[http://www.pravda.gov.mk/novost\\_detail.asp?lang=mak&id=1371](http://www.pravda.gov.mk/novost_detail.asp?lang=mak&id=1371).

<sup>24</sup><http://sds.org.mk/News.aspx?idNews=9353&lng=1&cat=3>

<sup>25</sup><http://www.akademik.mk/vladeeneto-na-pravoto-i-sudskata-nezavisnost-vo-fokusot-na-sredbata-ristovski-vuds/>

<sup>26</sup><http://bit.ly/2uFTkKO>

<sup>27</sup><http://ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf>





kohë për kontroll të punës së policisë, të konstatuar në shumicën e dokumenteve dhe raporteve, si të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të Këshillit të Evropës, Komisionit të Evropës, organizatave ndërkombëtare dhe organizatave joqeveritare nacionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”. I njëjti duhet t’i përfshijë të gjithë të punësuarit të cilët kanë autorizime policore si edhe policinë e burgut, me theks të veçantë mbi nevojën për përcaktim të përgjegjësive të të gjitha subjekteve të përfshira në procesin e vendosjes së mekanizmit të jashtëm.<sup>28</sup>

Dhe shoqëria qytetare realizoi disa aktivitete në fushën e sundimit të të drejtës. Më 19.07.2017 ishte prezantuar “Propozimi i organizatave qytetare për reforma urgjente demokratike”<sup>29</sup>, dokument i përgatitur nga shumica e organizatave qytetare dhe nga ekspertët të cilët ishin pjesë e procesit inkluziv (ku kanë marrë pjesë 146 persona, përkatësisht 73 organizata qytetare). Në këtë dokument janë inkorporuar qëllimi prioritar, masa dhe aktivitete për 3, 6, 9 dhe 12 muajt në vazhdim në një sërë fushash, duke përfshirë edhe gjyqësorin, luftën kundër korrupsionit dhe mediat, kështu që ai përfaqëson mbindërtimin e dokumentit të tillë iniciues të përgatitur në korrik të vitit 2017.

### **Liria e shprehjes dhe pluralizmi në media**

Me Planin e Qeverisë “3-6-9” në pjesën që lidhet me punën e mediave janë përfshirë edhe kërkesat për reforma të pesë shoqatave/organizatave dhe Propozim-ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale të marsit të vitit 2016, që ishte lëndë analize dhe dhënies së rekomandimeve nga Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, e cila qëndrimet dhe mendimet e veta i dërgoi në Ministrinë për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

Agjencia është vizituar nga Rajnhard Pribe dhe ekipi i tij ekspert, dhe kjo në suazat e agjendës për prioritetet urgjente reformuese të cilat dolën nga Raporti me rekomandime i vitit 2015. Në këtë takim janë përfshirë tema për mënyrën e funksionimit të trupit rregullator pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Shërbime Audio dhe Audiovizuale dhe Ligji për Media, pavarësinë politike dhe financiare të Agjencisë, për transparencën e saj, si dhe për dobësitë në sferën e mediave dhe për nevojën e tejkalimit të tyre, sidomos në aspektin e sanksionimit të gjuhës së urrejtjes, respektimin e standardeve gazetareske profesionale dhe sigurimin e kushteve për kryerje pa pengesë të punës së gazetarëve.<sup>30</sup>

Televizioni Kanal Viz nga Strumica, e informoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale se ekipi i tyre i gazetarëve i cili e ka ndjekur Këshillin e Komunës Novo Sellë, jo vetëm që është penguar ta kryejë obligimin profesional por edhe është ballafaquar edhe me sulmet verbale. Agjencia i dënoi format e tilla të trysnisë dhe ofendimeve ndaj gazetarëve dhe mediave është parakusht i domosdoshëm për funksionimin dhe zhvillimin e një shoqërie demokratike.<sup>31</sup>

<sup>28</sup><http://www.mvr.gov.mk/vest/4560>

<sup>29</sup>[http://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2017/07/Blueprint\\_2017\\_MK-01.pdf](http://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2017/07/Blueprint_2017_MK-01.pdf)

<sup>30</sup>[http://avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3312%3A2017-07-21-07-44-51&catid=171%3Anastani&Itemid=504&lang=mk](http://avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3312%3A2017-07-21-07-44-51&catid=171%3Anastani&Itemid=504&lang=mk)

<sup>31</sup>[http://avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3315%3A2017-07-26-09-36-12&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk](http://avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3315%3A2017-07-26-09-36-12&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk)



Njèkohësisht Agjencia e dënoi incidentin në Komunën e Çairit, ku ekipi i gazetarëve të TV Shenjës është ballafaquar me kërcënime nga personat, të cilët kanë pohuar se janë simpatizues të një partie politike.<sup>32</sup>

### Avokati i Popullit

Në korrik në Komisionin e Kuvendit për Financim dhe Buxhet u shqyrtuan ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit të RM-së, të cilat sipas Avokatit të Popullit, Ixhet Mexhiti, do ta dobësojnë edhe më tepër rolin e Avokatit të Popullit, duke marrë parasysh se ky institucion ka pavarësi ligjore të përcaktuar dhe e njëjta praktikisht do të jetë e pamundur me ndarjen e mjeteve përkatëse nga buxheti i RM-së. Në seancë, Memeti e ngriti dhe çështjen e punësimeve të reja në zyrën e Avokatit të Popullit, sepse as nuk janë paraparë mjete për këtë qëllim në rebalancin e buxhetit, as nuk ekziston miratim për punësime të reja duke u shpenzuar kështu mjetet të cilat janë në dispozicion në llogarinë e Avokatit të Popullit.<sup>33</sup>

Edhe Avokati i Popullit ka realizuar takim me Priben, ku biseda e të dy bashkëbiseduesve ishte me qëllim të sigurimit të funksionimit të pavarësisë dhe mbështetjen e vazhdueshme të institucionit, sidomos me ndryshimet e parapara në Ligjin e ri për Avokatin e Popullit dhe obligimet që dalin nga ai.<sup>34</sup>

### Diskriminimi

Më 12 korrik ministrja e arsimit dhe shkencës, dr. Renata Deskoska, e ka nënshkruar vendimin për propozimin për tërheqjen e librit shkollor “Shoqëria” për klasën e 4 të autores Biljana Zhivkoviç, pasi Avokati i Popullit ka vërtetuar se libri përmban diskriminim. Ankesa për të ishte dorëzuar nga 40 nëna të cilat jetojnë në familje me një prind, në bashkësi jashtëmartesore dhe bashkësi martesore, të mbështetura edhe nga tetë koalicione të tjera, midis të cilave Koalicioni “Të drejta seksuale dhe shëndetësore të grupeve të marginalizuara”. Ajo theksoi se: “Ushtrimi i tillë [i cili kërkon nga nxënësit të japin informacione për statusin martesor të prindërve, të sjellin fotografi nga dasma e tyre dhe të tregojnë se ku ka ndodhur lidhja e martesës], siç është dhënë në këtë libër është diskriminues dhe shqetësues për grupe të tëra prindërisht dhe fëmijësh të cilët nuk jetojnë në marrëdhënie martesore dhe familje konvencionale ... dhe nuk jep mundësi që fëmijët nga familjet jokonvencionale dhe marrëdhëniet martesore jokonvencionale pas u shqetësuar dhe pa stigmatizim t’i paraqesin marrëdhëniet në familjen apo shtëpinë e vet, sepse martesë si bashkësi dhe dasma si mënyrë për të festuar, janë prezantuar si bashkësitë dhe sjelljet e vetme “normale”.<sup>35</sup>

Pasi janë vërejtur një sërë reagimesh në publik, në lidhje me raportin diskriminues në Pishinën olimpike “Qendër” në Shkup ndaj një personi në karrocë invalide dhe pengimin për t’u futur në pishinë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut reagoi me dhënin e ndihmës dhe mbështetjes juridike pa pagesë për këtë rast, me përpjekje për të ndërmarrë të gjitha masat në drejtim të mbrojtjes së

<sup>32</sup>[http://avmu.mk/index.php?option=com\\_content&view=article&id=3308%3A2017-07-19-09-17-29&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk](http://avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3308%3A2017-07-19-09-17-29&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk)

<sup>33</sup><http://sdk.mk/index.php/makedonija/narodniot-pravobranitel-veli-deka-ni-vo-rebalansot-nema-pari-za-pomokna-zashtita-na-graganite/>

<sup>34</sup><http://ombudsman.mk/MK/aktivnosti/241416/sredba-na-narodniot-pravobranitel-g-idzhet-memeti-so-evrop-skiot-ekspert-za-reformski-prioriteti-g.aspx>

<sup>35</sup><http://coalition.org.mk/narodniot-pravobranitel-utvr-di-diskriminator-ska-sodrz-hina-vo-uchebnikot-opshtestvo-za-4-to-oddelenie/>



personave të diskriminuar dhe vazhdimin e luftës për mundësim të qasjes së tërësishme të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha subjektet. Nga Komiteti kujtuan se Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar Konventën e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me të cilën vendet anëtare janë të obliguara të ndërmerren masat përkatëse për sigurim që entitetet private të cilat ofrojnë kapacitete dhe shërbime të cilat janë të hapura apo të siguruara për publikun, t'i marrin parasysh të gjitha aspektet e qasjes së personave me aftësi të kufizuara. Mandej, trajtimi diskriminues është konstatuar edhe në përputhje me Ligjin për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili parashikon se diskriminimi i personave me aftësi të kufizuar fizike dhe mentale konsiderohet se ekziston edhe atëherë kur nuk do të ndërmerren masa për tejkalimin e kufizimeve, përkatësisht përshtatjen e infrastrukturës dhe hapësirës së përdorimit të resurseve publike në dispozicion, apo pjesëmarrje në jetën publike dhe shoqërore.<sup>36</sup>

Më 27 korrik, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, KHAM Dellçevë dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dorëzuan iniciativë për organizim të debatit publik të Komisionit të Përhershëm Anketues për të Drejtat e Njeriut për çështjen e kufizimit të të drejtës së lëvizjes së lirë dhe diskriminimit në kalimet kufitare përkundrejt qytetarëve të bashkësisë etnike romë, me qëllim që të jepen “propozime konkrete dhe të ndërmerren iniciativa konkrete për përmirësim të kornizës ligjore në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të përcaktuara të qytetarëve si dhe tejkalimin e praktikës sistematike për profilizim racor.”<sup>37</sup>

Prej këtyre organizatave, rikujtojnë se në periudhën nga viti 2011 dhe deri më sot praktika diskriminuese e MPB-së është përcaktuar në një numër të madh raportesh ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës, si edhe në raportet dhe në aktivitetet e tjera të shoqatave nacionale qytetare, kurse deri më tani janë ngritur 50 padi për përcaktim të të drejtës për trajtim të barabartë në kalimet kufitare, kurse pas marrjes së vendimeve negative gjyqësore, janë dorëzuar edhe 7 aplikime te Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të të drejtës së trajtimit të barabartë të shtetasve maqedonas - Romë nga Republika e Maqedonisë.

<sup>36</sup><http://www.mhc.org.mk/announcements/614?locale=mk#.WYNKJoiGPIV>

<sup>37</sup><http://www.mhc.org.mk/announcements/617?locale=mk#.WYNKJiiGPIV>